



**REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT**  
**AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE**  
**PA1 Nr.08-341**  
**27.10.2023**  
**Shkup**

Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 22, neni 20 paragrafi (1) nënparagrafi 10<sup>1</sup> dhe neni 70 paragrafët (1), (7) dhe (8) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20, 77/21 dhe 154/23), neni 15 paragrafi (1) nënparagrafi 19 dhe neni 39 paragrafi (1) nënparagrafi 10 të Rregullores së punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Tekst i pastruar) ark.nr.01-3732/1 datë 29.7.2019, neni 4 paragrafi (1) nënparagrafi 6 dhe neni 88 të Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.124/15) dhe neni 28 të Ligjit për kontest administrativ („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.96/19), dhe në pajtim me pikën 3, dhe në lidhje me pikën 1 të Vendimit të Këshillit të Agjencisë PA1 nr.08-55 datë 10.1.2023, Konkluzionin ark.nr.02-39/3 datë 10.1.2023, Studimin ark.nr.03-3610/3 datë 20.10.2023 dhe Konkluzionin ark.nr.02-3836/2 datë 26.10.2023, në seancën e 34-të mbajtur më 26.10.2023, miratoi si vijon:

### **VENDIM**

1. NUK SHPALLET konkursi publik për dhënie e lejes shërbimit programor televiziv me: format të përgjithshëm kryesisht argëtues, kryesisht format të përgjithshëm informativ dhe format të përgjithshëm në të cilin llojet e programeve të përfaqësuara i përmbushin të tre funksionet mediatike, në nivel shtetëror nëpërmjet multipleksit digjital tokësor, pasi që me Studimin ark.nr.03-3610/3 datë 20.10.2023, u konstatua se nuk ka arsyetim për shpallje të konkursit publik për dhënie e lejes për shërbime programore televizive për formatet e cekura të shërbimit programor televiziv.

2. Vendimi publikohet në ueb-faqen e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

3. Ky Vendim është përfundimtar.

### **A r s y e t i m**

Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia) në seancën e 1-rë të mbajtur më 9.1.2023, miratoi Vendim PA1 nr.08-55 datë 10.1.2023, me të cilën u refuzua Kërkesa me shkrim nga pala e interesuar, Shoqëria Tregtare Radiodifuzive 24 VESTI SHPKNJP Shtip ark.nr.03-67/1 datë 5.2.2020 (nr. ynë PA1 nr.08-55 datë 11.2.2020.) me plotësim ark.nr.03-958/2 datë 21.9.2020, (i ynë PA1 nr.08-94 datë 22.9.2020), për shpalljen e konkursit publik për dhënie e lejes për transmetim televiziv të shërbimit programor me format të përgjithshëm kryesisht informativ ose me format të përgjithshëm me tre funksione mediatike (informativ, arsimor dhe argëtues), në nivel shtetëror, nëpërmjet multipleksit digjital tokësor, për arsye që me Studimin për përcaktimin e arsytimit për shpalljen e konkursit publik për dhënie e lejes për transmetim televiziv në nivel shtetëror nëpërmjet multipleksit digjital tokësor (ark.nr.03-4391/4 datë 11.12.2020), u konstatua se nuk ekziston arsyetim për shpalljen e konkursit publik për dhënie e lejes për shërbime programore televizive me format të përgjithshëm kryesisht informativ dhe format të përgjithshëm në të cilin llojet e programeve të përfaqësuara i përmbushin të tre funksionet mediatike (informative, arsimore dhe argëtuese), në nivel shtetëror, nëpërmjet multipleksit digjital tokësor (pika 1 nga Ligji i cituar).

Në pikën 3 të Vendimit, u përcaktua se në pajtim me nenin 70 paragrafi (1) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV), me qëllim përcaktim të arsytimit për shpalljen e konkursit publik për dhënie e lejes për transmetim televiziv në nivel shtetëror nëpërmjet multipleksit digjital tokësor në vitin 2023, Këshilli i Agjencisë, në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga publikimi i Analizës së Tregut të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2022, sipas detyrës zyrtare do të

<sup>1</sup> Nënparagrafët 8 dhe 9 janë fshirë, shih: nenin 8 nga Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.248/18).

fillojë procedurë për dhënien e kontratës për furnizim publik për përgatitje të studimi për përcaktimin e arsytimit për shpallje të konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim televiziv në nivel shtetëror nëpërmjet multipleksit digjital tokësor“.

Rrjedhimisht nga sa mësipër, gjatë muajit korrik 2023, në përputhje me Ligjin për furnizime publike, Agjencia filloi procedurën për përzgjedhje të agjencisë së specializuar që do të përgatisë Studimin me të cilën do të përcaktohet nëse ka arsytim për shpalljen e konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim televiziv në nivel shtetëror nëpërmjet multipleksit digjital tokësor. Pas zbatimit të procedurës, u përzgjedh një agjenci e specializuar, e cila përgatiti Studimin për përcaktimin e arsytimit për shpallje të konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim televiziv në nivel shtetëror nëpërmjet multipleksit digjital tokësor (ark.nr.03-3610/3 datë 20.10.2023), e cila është publikuar në ueb-faqen e Agjencisë më 24.10.2023<sup>2</sup>. Studimi përmban pjesën hyrëse, pjesën në të cilën shpjegohet metodologjia e aplikuar gjatë përgatitjes, si dhe pjesët e mëposhtme: 1. Analizë ekonomike, 2. Analizë ekzistuese të ofertës mediatike dhe 3. Analizë të nevojave të publikut (audiencës). Pjesa e fundit nga Studimi - „KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME“ bashkon njohuritë nga të tre aspektet e analizuara dhe në bazë të saj është përcaktuar se: rezultatet e analizës ekonomike të tregut për transmetim të programit nëpërmjet multipleksit digjital tokësor na tregojnë se tregu ka hyrë në një periudhë stagnimi dhe rentabiliteti është në nivel më të ulët, që është një moment shumë i pafavorshëm për hyrjen e televizionit të ri në treg. Duke pasur parasysh se përmbajtjet programore të televizioneve që kanë leje për transmetim nëpërmjet multipleksit digjital tokësor në nivel shtetëror prekin të gjithë publikun në vend, është shumë me rëndësi që nëpërmjet tij, të sigurojë pluralizëm mediatik respektivisht, publikut t'i mundëson qasje kualitative dhe të ndryshme të përmbajtjeve. Ky Studim tregon se nuk ekziston arsytim për shpalljen e konkursit për shërbime programore televizive me: 1. format të përgjithshëm kryesisht argëtues, 2. format të përgjithshëm kryesisht informativ dhe 3. format të përgjithshëm në të cilën llojet e programeve të përfaqësuara realizojnë të tre funksionet e medias.

Në pajtim me nenin 70 paragrafi (1) nga LSHMAAV, Agjencia sjellë vendim për shpalljen e konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim televiziv dhe radio, sipas detyrës zyrtare ose me pranim të kërkesës me shkrim nga pala e interesuar, në pajtim me Planin për dhënien dhe përdorimin e radiofrekuencave, Plani për destinim dhe shpërndarje të kapaciteteve të multipleksit digjital tokësor, si dhe në pajtim me studimin nga paragrafi (3) të këtij neni.

Në nenin 70 paragrafi (7) nga LSHMAAV është përcaktuar se nëse me studimin nga paragrafi (4) i këtij neni u përcaktua se nuk ka arsytim për shpalljen e konkursit publik, Agjencia në afat prej tetë ditësh nga dita e publikimit të studimit do të marrë vendim me të cilin refuzon kërkesën nga paragrafi (1) i këtij neni.

Vendimi për mosshpalljen e konkursit publik në pajtim me nenin 70 paragrafi 8 nga LSHMAAV është përfundimtar, dhe kundër këtij vendimi mund të ngrihet padi para gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimin të vendimit.

Bazuar nga sa më sipër është miratuar Vendim si në dispozitiv.

**Agjencia për Shërbime Mediatike  
Audio dhe Audiovizuale  
Kryetari i Këshillit,  
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

**Këshillë juridike:** Ky vendim është përfundimtar, dhe kundër këtij vendimi mund të ngrihet padi para gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimin të vendimit.

---

<sup>2</sup> Studimi është publikuar në linkun në vijim: [Studim-për-përcaktim-të-arsytimit-për-shpallje-konkurs publik-për-TV-në-nivel-shtetëror.pdf \(avmu.mk\)](#)